



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 136, Datë 06.06.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 339, SERIA PV16K, DHËNË NGA BORDI I ERE-S ME VENDIMIN NR. 51, DATË 29.04.2016, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHPELLA POSHTË 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2300 KW**

Në mbështetje të neneve 16, 20 gërma “b” dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma “a” dhe 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866 prot., datë 30.05.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e e licencës Nr. 339, Seria PV16K, dhënë nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 51, datë 29.04.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Shpella Poshtë 2” me kapacitet të instaluar 2300 kW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “LIRIA ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 778 prot., datë 19.05.2022, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës nr. 339, Seria PV16K, dhënë nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 51, datë 29.04.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Shpella poshtë 2” me kapacitet të instaluar 2300 kW.
- Kërkesa për modifikim vjen për arsye se shoqëria ka rritur kapacitetin e instaluar të HEC-it “Shpella Poshtë 2”, nga 2300 kW, në 4530 kW.
- Shoqëria “LIRIA ENERGJI” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, bazuar në Aneksin A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, dhe ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar,

aplikanti duhet të depozitohet në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës; Vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; Miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera (lejet nga institucionet e tjera); Ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi; Të ketë kryer pagesat e aplikimit dhe të rregullimit në ERE.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

#### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

- Neni 9, pika 1, gërmat “a” (të dhënat për aplikim), gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe gërma “c” (të dhëna për aplikuesin).
- Neni 15 pika 4:
  - gërma “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.
  - gërma “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi.
  - gërma “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4

- gërma “b” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës). **Shoqëria duhet të depozitohet sa kërkuar nga kjo pikë e rregullores.**
- gërma “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. **Shoqëria duhet të depozitohet në ERE konfirmimin e VNM-së Paraprake, Lejes së përdorimit të burimit uhor nga organi përkatës, ose t’i përcjelli të rinovuara në vijim të ndryshimit të kapacitetit të instaluar. Po ashtu duhet të përcjellë në ERE edhe miratimin e pikës së lidhjes me operatorin e rrjetit më kapacitetin e ndryshuar. Shoqëria do të njoftohet që në zbatim të rregullores t’i paraqesë ato në afat.**

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2” me fuqi 2300 kW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**